Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1068

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga:Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "Menti" SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Rregullimi i hapësirës rreth shtatoreve te katër Gjeneraleve ne lagjen Karagaq RI-TENDER"me nr të prokurimit:"635-23-12223-5-2-1 ", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Peje, me datën 08.03.2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Menti" SH.P.K. , e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 29.12.2023 (me numër protokolli 1068/23) kurse vendimi i AK për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Rregullimi i hapësirës rreth shtatoreve te katër Gjeneraleve ne lagjen Karagaq RI-TENDER " me nr. të prokurimit: "635-23-12223-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Peje, mbetet në fuqi.

2.Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 03.11.2023, Kuvendi Komunal Peje , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i hapësirës rreth shtatoreve te katër Gjeneraleve ne lagjen Karagaq RI-TENDER" me nr. të prokurimit: "635-23-

12223-5-2-1". Nderkaq me datën 11.12.2023 eshte publikuar njoftimi mbi vendimin e AK. Ku është anuluar procedura e prokurimit.

OE "Menti" SH.P.K. me datën 16.12.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. AK-Kuvendi Komunal Peje merr vendim qe te refuzohet si e pa bazuar kërkesa per ri-shqyrtim e OE "Menti" SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i hapësirës rreth shtatoreve te katër Gjeneraleve ne lagjen Karagaq RI-TENDER" me numër te prokurimit: "635-23-12223-5-2-1" inicuar nga Autoriteti Kontraktues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE "Menti" SH.P.K. ankues me datën 29.12.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 1068/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: Punë, vlera e parashikuar e kontratës:281,967,50€.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palet me raportin e ekspertizes ku dhe, Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 16.01.2024 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "Menti" SH.P.K. tëaprovohetsi e bazuar,të anulohet njoftimit mbi vendimin AK dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me cështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, të Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertriza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftushme për të vendosur ne aspektin meritor.

PËRMBLEDHJE DHE PERGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Pretendimi 1

OE ankues pretendon që: *"AK-gjate procesit te Vleresimit te Tendereve ka konstatuar se jemi 2 oferta konkuruese dhe te dyja te pergjegjshem, nuk ka proceduar me paragrafin 1.2 te ketij neni. Pra AK ka shkele nenin 60 paragrafin 1.2."*

Sa i përket këtij pretendimi, eksperti sqaron se ky nuk është një pretendim ankimor sepse nuk përmban fakte dhe as prova të cilat mund të shqyrtohen nga ana e ekspertit, për të vlerësuar se a qëndron apo jo ky pretendim.

Pretendimi 2

"AK- me rastin e njoftimit me Vendimin e dates 11.12.2023 eshte thirre ne Nenin 62 paragrafi 2.2, ku ne asnjeren nga theniet e këtij pragrafi nuk gjene Arsyetimin per Anulim te AP. Vlenë të theksohet se Aktiviteti i Prokurimit ne fjalë edhe një here brenda ketij viti eshte anuluar ne munges te ofertave konkuruese. AK gjatë procesit të anulimit, gabimisht eshte thirr ne nenin 62 të LPP-së, pragrafi 2.2 sepse FDT e ka te theksuar piken 5.2 se afati i permbushjes se kontrates eshte 365 dite kalendarike qe i bie se ky projekt eshte buxhetuar per vitin 2023 dhe 2024 thenja se gjoja grantet qeveritare nuk mund te shfrytezohen kete vit nuk qendron sepse AP eshte iniciuar me daten 03.11.2023 dhe hapja e ofertave me daten 27.11.2023 qysh para hapjes se ofertave eshte dite shume qarte se shfrytezimi i mjeteve buxhetore per vitin fiscal 2023 eshte pothuajse i pamundur, per arsye te procesit i cili duhet te kaloj te gjitha fazat, vleresimi i ofertave, njoftimi i kandidateve mbi rezultatin e njoftimit, afatet ligjore ne pritje te njdonje kerkese per rishqyrtim do te ishte e pa mundur qe kontrata te nenshkruhet para 15.12.2023."

Eksperti pasqyron se me datën 11/12/2023 AK ka marr vendim për anulim të procedurës së prokurimit në pajtim me nenin 62, pika 2.2 të LPP-së, me arsyetimin se: citim *"Është e pamundur lidhja e kontratës dhe ekzekutimi i punimeve brenda afatit të cilat do të mundësojnë shfrytëzimin e mjeteve nga grandi qeveritar të cilat kanë qenë të planifikuara për vitin 2023 dhe këto mjete AK nuk mund t'i ketë në dispozicion në buxhetin e përfshirë për vitin 2024, nga Grandi Qeveritar dhe nga të hyrat e KK Pejë. Prandaj AK ka marrë vendim për ANULIMIN e procedurës dhe shkaqe të pamundësisë Financiare"*. Duke u bazuar në pikën 2.2 të nenit 62 të LPP-së, ky nen flet për anulimin e procedurës së prokurimit para hapjes së tenderëve, AK në rastin konkret ka bërë hapjen e tenderëve dhe procesverbali i hapjes mund të gjendet i bashkëngjitur edhe në sistemin e-prokurimi, pra që do të thotë se kjo pikë e këtij neni nuk mund të vlejë për këtë rast. Për më tepër eksperti sqaron se AK ka publikuar njoftimin për kontratë më datë 03/11/2023 dhe në DT e ka cekur se afatet kohore për fillimin dhe/ose përfundimin e kontratës është 365 ditë kalendarike, në po të njëjtën datë është nënshkruar edhe deklarata e nevojave me shumën e paraparë për këtë procedurë. Vetëm pas 24 ditësh, AK në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga OE ankues pranon faktin se me datën 27/11/2023, ka marrë konfirmimin nga ZKF që për projektin e lartcekur nuk kemi mjete për realizimin e projektit pasi që mjetet janë tërhequr nga përmbaruesit, mirëpo AK nuk ka nxjerrë vendimin e anulimit deri më datë 11/12/2023.

Sipas ekspertit një veprim i tillë nga AK nuk është aspak korrekt dhe tregon një jo seriozitet të lartë nga ana e tyre. Siç edhe kanë qenë në dijeni, granti qeveritar i cili është planifikuar të përdoret për këtë procedurë prokurimi, ka vlejtur për vitin 2023 dhe publikimi i Njoftimit për Kontratë për më pak se dy muaj para përfundimit të vitit po ashtu nuk duket në rregull. Si çdo procedurë tjetër prokurimi e cila zhvillohet, AK është dashur të parashikoj se njësoj edhe me këtë procedurë mund të ketë vonesa në ofertim si pasojë e ndonjë kërkese për rishqyrtim apo ankese në kriteret e DT-së, apo vonesa pas ofertimit dhe publikimit të rezultateve përfundimtare. Për më tepër, mjetet të cilat janë ndarë për një aktivitet të caktuar, nuk mund të orientohen për një aktivitet tjetër. Mjetet të cilat janë tërhequr nga përmbaruesit nuk kanë lidhje me mjetet të cilat janë ndarë si grant i qeverisë, këto mjete të cilat janë parparë për një aktivitet nuk mund të

përdoren si shlyerje e borxheve të caktuara për detyrime të tjera. Granti i cili është ndarë për periudhën një vjeçare, vlenë për periudhën e ndarë deri në fund të atij viti.

Edhe një herë për të sqaruar, thirrja e AK-së në nenin 62, pika 2.2 e LPP-së për anulim të kësaj procedure të prokurimit është e gabuar sepse kjo pikë përshkruan veprimin e AK-së në rastin para se të bëhet hapja e ofertave dhe jo pas hapjes siç është rasti konkret. Anulimi i procedurës së prokurimit duke u thirrur në këtë nen, nuk është në përputhje me LPP-në. Andaj, vlerësojmë që ky pretendim i ngritur është i bazuar.***- Vlerësimi dhe administrimi i provave*** –Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjjet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Sipas të thënave si më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues*OE* "Menti" SH.P.K.Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues mbështet të gjeturat në raportin e ekspertit shqyrtues, pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish. Por Paneli Shqyrtues nuk e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim.

Konstatimet e panelit shqyrtues

Pavarësisht rekomandimeve, Paneli shqyrtues vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik. Prandaj Paneli shqyrtues mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues që në aktivitetin e zhvilluar nga ana e AK ka pasur shumë shkelje dhe ndryshime të rrethanave për shkak të neglizhencës së AK, ku pësojnë OE ofertues. Fillimisht, inicimi i aktivitetit të prokurimit në fundin e viti 2023, kjo paraqet një papërgjegjshmëri totale e zyrtarëve të këtij autoriteti kontraktues duke i shkaktuar edhe humbje të mjeteve të dedikuara për Komunën dhe qytetarët si përfitues të këtij projekti. Ngase, Deklarata e Nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve, si dokument i domosdoshëm për inicim të aktivitetit të prokurimit është nënshkruar pothuajse 2 muaj më parë, para se të publikohet njoftimi për kontratë i kësaj procedure. Po ashtu, të bëhet inicimi i kësaj procedure dhe menjëherë pas disa ditës të vjen një konfirmim nga ZKF se nuk ka mjete për këtë aktivitet, kjo definitivisht është shkelje e komplet dispozitave ligjore.

Sipas njoftimit mbi vendimin e AK (B58), ky aktivitet i prokurimit është anuluar me arsyetimin se mjetet e parapara për këtë aktivitet të prokurimit "Është e pamundur lidhja e kontratës dhe ekzekutimi i punimeve brenda afatit të cilat do të mundësojnë shfrytëzimin e mjeteve nga grandi qeveritar të cilat kanë qenë të planifikuara për vitin 2023 dhe këto mjete AK nuk mund t'i ketë në dispozicion në buxhetin e përfshirë për vitin 2024, nga Grandi Qeveritar dhe nga të hyrat e KK Pejë. Prandaj AK ka marrë vendim për ANULIMIN e procedurës dhe shkaqe të pamundësisë Financiare". Lidhur me këtë OSHP me qëllim të vërtetimit të saktë të gjendjes reale, më dt. 28.02.2024, ju drejtohet zyrës së prokurimit me këtë email "Jemi në shqyrtim të ankesës nr. 2023/1068 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i hapësirës rreth shtatoreve te katër

Gjeneraleve ne lagjen Karagaq RI-TENDER" me nr. të prokurimit: "635-23-12223-5-2-1", inicuar nga AK Komuna e Pejës dhe arsyeja e anulimit te aktivitetit te prokurimit eshte mungesa e mjeteve financiare, andaj luteni qe ne afat sa me te shkurter kohor te na ofroni deshmite konkrete per mungesen e mjeteve financiare , konkretisht deshmi lidhur me arsyet e anulimit".

Zyra e prokurimit në AK Shërbimi Korrektues i Kosovës, kthen emailin me dt. 01.03.2024, duke e bashkangjitur buxhetin per vitin 2024, panifikimin e prokurimit per vitin 2024, si dhe shkembimin e emailit me ZKF se nuk ka mjete për këtë aktivitet të prokurimt dhe me këtë arsyetim "*Te nderuar/a, ju njoftoje ne lidhje me kerkesen tuaj per informata shtese ne lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: Rregullimi i hapesires rreth shtatoreve te kater Gjeneraleve ne lagjen Karagaq RI-TENDER me nr. te prokurimit 635/23/12223/521 se une si zyrtar pergjegjes i prokurimit kam kerkuar nga ZKF qe te na tregoj me shkrim se a kemi mjete per aktivitetin e Anuluar nga ana jone per vitin 2024 dhe nga ZKF kemi pranuar emailin, ku ne po ju percjellim edhe emailin qe kam shkembyer me ZKF dhe poashtu edhe Planifikimin e Buxhetit dhe Planifikimin e Prokurimit".*

Andaj, Paneli Shqyrtues duke u bazuar në RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK Neni 8 .5 nder te tjera thotë: Personat përgjegjës për nënshkrimin e kontratës dhe DNPDF janë të obliguar që para publikimit të Formularit B58 "Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", të ri konfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar.

Tek Disponueshmeria e mjeteve Neni 3: Shqyrtimi, nder te tjera shënon: Kjo "Deklaratë e Nevojave dhe e Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve" duhet të shqyrtohet nga personat e autorizuar për nënshkrim te kontratave para publikimit te Njoftimit për dhënie te kontratës me qëllim që të ri konfirmojë se informatat financiare nuk kanë ndryshuar materialisht. Në ketë rast pas shqyrtimit nga personat e autorizuar para publikimit te njoftimit për dhënie te kontratës, zyra e prokurimit ka pranuar shkresën ku saktëson se ka ndryshim te mjeteve buxhetore se ky projekt nuk mund te realizohet për arsyet e cekura më lartë. Nëse i referohemi LPP-së Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Dispozitë e këtij ligji është edhe neni 8.5 i Rregullores se Prokurimit Publik gjithashtu edhe Rregullat financiare me nr. 01/2013/MF – Shpenzimi i Parave Publike.

Bazuar në RREGULLEN FINANCIARE NR.01/2013/MF – SHPENZIMI I PARAVE PUBLIKE Neni 13 Menaxhimi i projekteve kapitale "Projektet kapitale menaxhohen me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Ligji për ndarjet buxhetore përmban vlerësimet se sa do të shpenzohen në secilin projekt dhe në secilin vit. SIMFK përmban kufizime ashtu që fondet e alokuara në kategorinë ekonomike të "kapitalit" mund të zotohen vetëm për projekte të tilla. Nëse një projekt kapital duhet të realizohet në vitin e tanishëm, dhe është vonuar, atëherë fondet mund të zotohen në një vit në të ardhmen për ta përfunduar projektin kapital vetëm nëse kjo pasqyrohet në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, nga ndarjet buxhetore të vitit të

ardhshëm të BRK".

Kështu që, si pasojë e gjendjes së krijuar, përgjegjësin e mban vetë autoriteti kontraktues edhe sa i përket përmbajtjes së të gjitha shkresave, ndërsa, PSh detyrimisht duhet ta lë në fuqi anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, sepse në të kundërtën do të bie ndesh me parimet dhe dispozitat e prokurimit publik si dhe rregulloret financiare. Si rrjedhoj, AK nuk mund të vihet në një gjendje ku do ta kishte të pamundur nënshkrimin e kontratës pa i pasur mjetet në dispozicion. Andaj, paneli shqyrtues duke u bazuar në këtë informacion të detajuar dhe duke u bazuar edhe në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues u bind se ky aktivitet të prokurimit duhet të anulohet në tërësi dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK për anulim. Andaj Paneli e konsideroj të arsyeshme që me rastin e vendosjes meritore në këtë çështje juridike-administrative, tua njeh të drejtën e kthimit të tarifës ankimore.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe nevojat e tij/saj AK në rastin konkret të vendos për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe për këtë mbajnë përgjegjësi, bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, dhe të prolongimi deri në pafundësi të aktivitetit të prokurimit, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi sikurse në pikën 2, të dispozitivit është marrë ne kuptim te nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores se punës se Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E PEJES**
- OE - **„Menti Sh.p.k.**
- Arkivës së OSHP-së: